



**AGJENCIA  
KOMBËTARE  
E DIASPORËS**



**AGJENCIA  
KOMBËTARE  
E DIASPORËS**



**AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS**

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË  
CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

Nr.272/2 Prot Tiranë, më 14.09.2020

Nr.201/1 Prot Tiranë, më 14.09.2020

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

**NDËRMJET**

**AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS**

**DHE**

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**



Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, të cilat në vijim të këtij dokumenti do të quhen *Palë*:

*Duke patur parasysh objektin e veprimtarisë institucionale të tyre;*

*Duke vlerësuar rëndësinë e bashkëpunimit me Diasporën shqiptare me qëllim dhënien e bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, duke kontribuar në ndërtimin e urave lidhëse me vendlindjen;*

*Me dëshirën për të nxitur forcimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit me Diasporën shqiptare, për të ndihmuar në ruajtjen e gjuhës shqipe, kulturës dhe traditave kombëtare me mundësimin për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare për të studiuar në Republikën e Shqipërisë;*

*Duke afirmuar vullnetin dhe vendosmërinë për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e kësaj Marrëveshje për të përmbushur angazhimet në kuadër të Vendimit Nr. 686, datë 02.09.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e diasporës për vitin akademik 2020-2021”,*

Bien dakord si vijon:

### **Neni 1 Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është dhënia e bursave dhe përcaktimi i kriterëve për përfitimin e tyre, sipas programeve të studimit për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare të cilët përfitojnë bursa studimi në Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 2 Parimet e përgjithshme**

1. Palët në këtë marrëveshje udhëhiqen nga parimi i barazisë dhe përfitimit reciprok. Palët kontribuojnë në zbatimin e kësaj marrëveshje në përputhje me mundësitë dhe kompetencat që kanë sipas legjislacionit në fuqi.
2. Palët njohin interesin e përbashkët në forcimin, përmirësimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit me diasporën shqiptare.

### **Neni 3 Kriteret bazë për përfitimin e bursës**

Kriteret bazë për përfitimin e bursës për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare janë:



- a) Të ketë mbaruar arsimin e mesëm me një mesatare të përgjithshme mbi 8 (tetë) ose të barasvlefshme me të;
- b) Të mos jetë i diplomuar në ciklin e plotë të studimeve universitare;
- c) Të jetë student nga komunitetet shqiptare të diasporës dhe që jeton në një nga vendet e mëposhtme:
  - Pjesë e komunitetit shqiptar në Ukrainë;
  - Pjesë e komunitetit Arbëresh në Itali;
  - Pjesë e komunitetit shqiptar në Kroaci;
  - Pjesë e komunitetit shqiptar në Bullgari.

#### **Neni 4**

#### **Kriteret shtesë për përfitimin e bursës**

Studentët, shtetas të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursë duhet të plotësojnë edhe këto kritere:

- a) Të jenë studentë në një nga fushat prioritare të studimit, të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshje;
- b) Të kenë vërtetim nga universiteti se janë studentë aktivë që nuk kanë përfunduar ciklin e plotë të studimeve;
- c) Të jenë pranuar nga një institucion i akredituar i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë;
- d) Të kenë një plan pune dhe aktivitete kërkimore apo akademike gjatë periudhës studimore në Shqipëri;

#### **Neni 5**

#### **Fushat prioritare të studimit**

Studentët, shtetas të huaj me origjinë shqiptare, që përfitojnë bursa nga shteti shqiptar duhet të jenë studentë në një nga këto fusha:

- a) Shkencat shoqërore
  - a. Psikologji
  - b. Ekonomi dhe biznes
  - c. Edukim
  - d. Sociologji
  - e. Ligj/drejtësi
  - f. Shkenca politike
  - g. Gjeografi
  - h. Media dhe komunikim



- i. Shkenca të tjera sociale
- b) Shkenca humane dhe arte
  - a. Histori
  - b. Arkeologji
  - c. Gjuhë
  - d. Letërsi
  - e. Arte
  - f. Shkenca të tjera humane

### **Neni 6** **Paraqitja e dokumenteve**

Dokumentet që shoqërojnë aplikimin dhe vërtetojnë plotësimin e kriterëve duhet të jenë të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën shqipe.

### **Neni 7** **Përpunimi i të dhënave personale**

Palët lejojnë përpunimin e të dhënave në funksion të kësaj marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të njëjtat të dhëna mund të përfshihen në bazat e të dhënave, skedarët kompjuterikë dhe sistemet telematike vetëm për qëllimet që lidhen me këtë Marrëveshje.

### **Neni 8** **Format e bashkëpunimit**

Palët janë dakorduar që kjo marrëveshje nuk do të përjashtojë mundësitë e formave të tjera të bashkëpunimit me subjekte të tjera që nuk janë palë e kësaj Marrëveshjeje.

### **Neni 9** **Përgjegjësia**

Palët nuk janë përgjegjëse për mosmarrëveshjet që mund të ketë secila prej tyre me palë të treta.

### **Neni 10** **Kohëzgjatja, procedura e rinovimit dhe e drejta e tërheqjes**

1. Marrëveshja hyn në fuqi me nënshkrimin nga Palët.
2. Kjo Marrëveshje ka një kohëzgjatje të pacaktuar. Rast pas rasti për aktivitetet nga të dyja palët do të hartohet një aneks kontratë.



3. Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje me anë të komunikimit me shkrim. Marrëveshja do të përfundojë pas një (1) muaji nga data kur pala tjetër ka pranuar njoftimin për t'u tërhequr nga lidhja e kësaj marrëveshje. Tërheqja e palëve nga kjo marrëveshje nuk prodhon efekte mbi marrëdhëniet që kanë filluar të ekzistojnë gjatë kohës që kjo marrëveshje ka qënë në fuqi.

#### **Neni 11**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshje zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

#### **Neni 12**

#### **Gjuha e marrëveshjes**

Kjo Marrëveshje hartohet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale, 2 (dy) kopje për Agjencinë Kombëtare të Diasporës dhe 2 (dy) kopje për Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Nënshkruar në Tiranë, në 14.09.2020.

**AGJENCIA KOMBËTARE E DIASPORËS**

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË  
CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

**DREJTOR**

**SONILA HYSI**

**ELVIN GJEVORI**